



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 21.07.20 Ref.: 973/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

**V E N D I M**

- I. Nuk akreditohet Kolegji Dukagjini në nivel institucional.
- II. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të kolegjit Dukagjini për vitin akademik 2020 – 2021 deri në periudhën tjetër të riakreditimit institucional.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

**Arsyetimi**

I. Kolegji Dukagjini ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional të cekur në dispozitivin I të këtij vendimi.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtar të akreditimit në Kolegjin Dukagjini më datë 22.05.2019 me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Milan Pol, Janez Vogrinc dhe Keti Tsozniashvili.

Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Dukagjini dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, konstaton se Kolegji Dukagjini nga gjithsej 11 kapituj të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit i përmbush standardet si vijon: e përmbush plotësisht një (1) kapitull (Planifikimi dhe menaxhimi financiar), e përmbush substancialisht një (1) kapitull (Burimet dhe hapësirat), i përmbush pjesërisht dy (2) kapituj (Integriteti akademik, Mësimdhënia dhe të nxëniti), dhe nuk i përmbush shtatë (7) kapituj (Misioni publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi strategjik; Menaxhimi i cilësisë; Hulumtimi; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Bashkëpunimi institucional).

Sipas ekspertëve, Raporti i Vetëvlerësimit të Kolegjit Dukagjini është shumë problematik për arsyet e mëposhtme: raporti pasqyron më së shumti informacionin për Kolegjin UBT dhe jo për Kolegjin Dukagjini, ai nuk specifikon rezultatet e vetëvlerësimit për Kolegjin Dukagjini, informacionet faktike në disa raste nuk janë të sakta, gjatë intervistave stafi i kolegjit nuk mund të shpjegojë disa nga informacionet e dhëna në raport. Kështu që, procesi i vetëvlerësimit, i cili është një instrument thelbësor për sistemin e sigurimit të cilësisë nga ana e Kolegjit Dukagjini, nuk është realizuar siç duhet.

*Kapitulli i parë (Misioni publik dhe objektivat institucionale / Nuk përmbushet)*, ekspertët vlerësojnë se misioni i kolegjit i cili është formuluar në Raportin e Vetëvlerësimit paraqitet në disa pjesë në formë të fjalive të cilat mund të kuptohen si deklaratat e misionit, por nuk ka një deklaratë të shkurtër, të qartë dhe të matshme që do të pasqyronte veçantinë e kolegjit brenda kontekstit kombëtar ose më të gjerë. Përkundrazi, ka shpeshherë formulime të paqarta, të cilat në një ose në një mënyrë tjetër theksojnë edukimin, hulumtimin dhe nganjëherë një shtrirje më të gjerë të kolegjit. Në fakt, deklaratat e misionit ngatërrohet shpeshherë me objektivat. Ngjashëm, në raport ka informata për ndarjen e misionit me komunitetin e kolegjit, por nuk ka informacion konkret se si është realizuar kjo. Përkundrazi, kjo pjesë e raportit koncentrohet fuqishëm në mënyrën se si realizohen këto procese në Kolegjin UBT. Prandaj, nuk është plotësisht e qartë se si misioni i kolegjit shërben si një udhëzues efektiv për planifikim strategjik, vendimmarrje dhe organizim të këtij institucioni. Në fakt, në këtë aspekt, raporti thekson kryesisht rëndësinë e një ndërlidhjeje shumë të ngushtë me Kolegjin UBT. Mënyra e zhvillimit të vetë kolegjit Dukagjini mbetet në hije në këtë kontekst. Kur kërkohen të dhënat për mënyrat se si objektivat afatmesëm dhe afatgjatë institucionale janë në përputhje me misionin e Kolegjit Dukagjini, sërish është dhënë informacioni përkatës për Kolegjin UBT.

*Kapitulli i dytë (Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi / Nuk përmbushet)*: Sipas ekspertëve, në informatat e Kolegjit Dukagjini lidhur me planin e tij strategjik me pesë objektivat kryesore dhe disa qëllime, titujt nuk janë gjithmonë të qartë dhe disa informacione janë shumë konfuzë. Objektivat kryesore janë përpunuar në shtrirje të ndryshme, disa përmbajnë një numër detyrash, e disa tjera vetëm pak detyra. Plani Strategjik, siç u prezantua, nuk përmban tregues ose instrumente të tjera që mundësojnë të përcaktojnë nëse janë përmbushur objektivat dhe detyrat, pra kolegji ka dështuar të vendosë indikatorë matës. Nuk tregohet afati kohor dhe informacioni konkret në lidhje me mbështetjet financiare të lidhura posaçërisht me objektivat dhe detyrat individuale. Po ashtu, informacionet lidhur me mënyrën e hartimit të planit strategjik dhe mënyrën e integritit të procesit të buxhetimit vjetorë dhe afatgjatë, përqendrohen në Kolegjin UBT e jo në Kolegjin Dukagjini, dhe kjo është vërtetuar edhe gjatë intervistave. Probleme gjithashtu janë evidentuar në të dhënat që i janë ofruar panelit vlerësues, si p.sh.



dokumentacion ku vërehen ndikimet e mundshme të institucionit Kolegji UBT, dhe monitorimi i planit strategjik (nga po ky kolegji). Pra nuk ekziston një vijë e qartë e cila përcakton formën e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve dhe atë se deri në çfarë mase Kolegji Dukagjini mund ta ruaj pavarësinë e saj institucionale si entitet i veçantë juridik.

*Kapitulli i katërt (Integriteti akademik, përgjegjësia dhe përgjegjësia publike / Përmbushet pjesërisht):* Ekspertët vërejnë se Kolegji Dukagjini e ka kodin e etikës, dhe në ueb faqe figuron vetëm në gjuhën shqipe, dhe ekspertëve u është dërguar në gjuhën angleze vetëm pas vizitës. Po ashtu, gjatë vizitës është konfirmuar se kolegji Dukagjini deri më tani nuk ka punuar me ndonjë softuer antiplagjiaturë, por synon të adoptojë një nga Kolegji UBT dhe ta përdorë atë në një të ardhme të dukshme. Meqenëse ueb faqja e kolegjit është vetëm në gjuhën shqipe, ekspertët nuk mund të konfirmojmë nëse të gjitha rregulloret e brendshme, procedurat, raportet e vetëvlerësimit dhe vendimet e organeve drejtuese janë në dispozicion për publikun. Rekomandimi i ekspertëve është që të krijohet ueb faqja në gjuhën angleze si dhe të sigurohet programi antiplagjiaturë dhe të përdoret në mënyrë efektive.

*Kapitulli i pestë (Menaxhimi i cilësisë / Nuk përmbushet):* Struktura organizative e kolegjit ose statuti nuk përfshijnë informacione rreth komisionit për sigurim të cilësisë (përbërjes, funksioneve dhe detyrave të tij). Statuti gjithashtu nuk përfshin ndonjë informacion në lidhje me sistemin e sigurimit të cilësisë ose zyrën e sigurimit të cilësisë në kolegji. Megjithatë RVV ofron informacione për komisionin për sigurim të cilësisë, anëtarët e komisionit që janë të shënuar si staf akademik nuk janë në listën e stafit akademik të Kolegjit Dukagjini të siguruar nga i njëjti RVV. Kështu, ekspertët konstatojnë se informacioni në lidhje me komisionin për sigurim të cilësisë që jepet në RVV kanë të bëjë me UBT ose ndoshta për ndonjë kolegji tjetër, por jo me Kolegjin Dukagjini. Ekspertët nuk kanë mundur të gjejnë politikat dhe ligjet për sigurimin e cilësisë, edhe pse në raport thuhet se publikohen në ueb faqen e kolegjit. Sa i përket vlerësimit të kurseve dhe mësimdhënësve në fund të çdo semestri, ekspertët mendojnë se mënyra dhe instrumentet matëse nuk janë të duhura, dhe nuk është mjaft e qartë se si vlerësohet secila komponentë. Gjatë intervistave, ekspertët nuk kanë mundur të identifikojnë praktikat kur programet janë përmirësuar si rezultat i vlerësimit të cilësisë. Sipas strukturës organizative zyra për sigurim të cilësisë është themeluar brenda administratës qendrore të institucionit, megjithatë rregulloret nuk përcaktojnë funksionet e saj ose skemën e raportimit dhe marrëdhëniet me njësitë e tjera.

*Kapitulli i gjashtë (Mësimdhënia dhe të nxëniet / Përmbushet pjesërisht):* Kolegji nuk ka politika dhe procedura që zbatohen për të gjitha programet akademike. Sipas RVV, kolegji ka zhvilluar strategjinë e mësimnxënies dhe mësimdhënies, megjithatë përshkrimi që jepet në lidhje me këtë strategji nuk definon politikat dhe procedurat themelore që duhet të ndjekë çdo program arsimor, siç janë parakushtet dhe procedurat për hapjen e një programi të ri, rishikimi i programeve ekzistuese dhe përbërësit themelore dhe struktura që duhet të përfshijë çdo program arsimor, dhe organizimi i procesit të studimit. Në statutin e kolegjit thuhet se “studimet brenda kolegjit kryhen në anglisht, shqip dhe në disa programe në gjuhë të tjera”, megjithatë kolegji deri më tani ka vetëm dy programe të akredituara që zbatohen në gjuhën shqipe, kështu që ky nen në statut është i paqartë. Ekspertët nuk kanë mundur të gjejnë ndonjë provë për bashkëpunim me universitetet që janë dhënë në programe, siç është cekur në raport të kolegjit.



*Kapitulli i shtatë (Hulumtimi / Nuk përmbushet):* Sipas ekspertëve, kolegji Dukagjini nuk ka ndonjë plan zhvillimor as objektiva për hulumtime, sepse të gjitha informacionet lidhur me aktivitetet kërkimore nga raporti i vetëvlerësimit kanë të bëjnë me UBT. Gjithashtu, Raporti i Vetëvlerësimit nuk tregon për buxhetin e caktuar për hulumtime në kolegji. Nuk ka të dhëna për ndonjë projekt kërkimor në të cilin marrin pjesë mësimitdhënësit e kolegjit. Sipas intervistave me mësimitdhënësit, thuhet që publikimet e tyre bëhen nën emrin e kolegjit Dukagjini dhe UBT, kështu që ata në fakt nuk publikojnë nën emrin e institucionit të cilit i përkasin. Sipas ekspertëve, si në RVV ashtu edhe gjatë intervistave me stafin akademik, nuk ekziston ndonjë kriter specifik për vlefshmërinë e punës hulumtuuese, si dhe nuk ka indikacione se stafi akademik ka të botuar së paku një punim shkencor në tre vjetët e fundit. Raporti i vetëvlerësimit nuk përmban ndonjë referencë për udhëzimet për pronësinë intelektuale ose procedura të qarta për komercializimin e ideve të hartuara nga stafi dhe studentët e Kolegjit Dukagjini. Nuk ka asnjë referencë për politikën, procedurat dhe njësitë strukturore përkatëse për të siguruar që parimet etike respektohen në hulumtime.

*Kapitulli i tetë (Stafi, procedurat e rekrutimit dhe zhvillimi profesional / Nuk përmbushet):* Sipas ekspertëve, shifrat që japin numrin e të punësuarve në Kolegjin Dukagjini janë të paqarta dhe ndryshojnë nga RVV dhe intervista me menaxhmentin, prandaj ekspertët nuk janë në gjendje të japin informacione për kualifikimet e stafit si dhe proporcionin e studentëve me mësimitdhënësit e rregullt në kolegji. Sa i përket procesit të rekrutimit, në RVV ekspertët nuk kanë gjetur informacione, ndërsa gjatë intervistave me dekanët dhe shefat e departamenteve janë informuar se nëse kanë nevojë për staf akademik në Kolegjin Dukagjini, së pari kontrollojnë nëse kanë dikë me kualifikime të përshtatshme në UBT, por nuk është e qartë se si funksionon procesi i rekrutimit nëse duan të marrin dikë nga UBT. Gjithashtu nuk është e qartë nëse procesi i rekrutimit është i lidhur me strategjinë e zhvillimit të Kolegjit Dukagjini, edhe këtu informacionet e dhëna janë të lidhura me kolegjin UBT. Gjatë intervistave me stafin akademik, ekspertët nuk kanë marrë informacione se si personeli i ri akademik merr udhëzime efektive për familjarizim me kolegjin Dukagjini në përgjithësi. Përkundrazi, ishte e qartë se mësimitdhënësit marrin shumë më tepër informacione rreth UBT, dhe ata nuk dallojnë specifikat mes dy kolegjeve. Sa i përket kriterëve të vlerësimit të stafit akademik, nga asnjëra intervistë ekspertët nuk mundën të marrin informacione të duhura. Kolegji Dukagjini nuk ka një plan të qartë për zhvillimin profesional të të gjithë stafit, dhe ekspertët gjithashtu nuk morën asnjë informacion në lidhje me mundësitë për zhvillim personal dhe profesional të stafit akademik dhe administrativ në Kolegjin Dukagjini.

*Kapitulli i nëntë (Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse / Nuk përmbushet):* Seksioni mbi administrimin e studentëve dhe shërbimet mbështetëse në raportin e vetëvlerësimit jep informacione për UBT dhe jo për Kolegjin Dukagjini. Ky vlerësim bazohet në dokumentet dhe informacionet që jepen në faqen e internetit të kolegjit, dokumentet e kërkuara pas vizitës dhe rezultatet e intervistave. Ueb faqja e kolegjit përfshin vetëm përshkrimin e shkurtër të programeve arsimore, përgjegjësitë e studentëve, kodin etik të studentëve dhe rregulloren për vlerësimin e studentëve, por nuk ka informacione për kurset e programit, shërbimet në dispozicion, mundësitë e bursave, shkollimit dhe tarifat e tjera administrative. Në kohën e vizitës, kolegji nuk kishte manual të studentëve të botuar në ueb faqen e kolegjit, dhe studentët nuk ishin në dijeni për ndonjë manual. Kolegji nuk ofron një orientim në lidhje me politikën, procedurat, shërbimet dhe burimet që janë në dispozicion në kolegji. Ekspertët vërejnë se kolegji nuk ka ndonjë mekanizëm për të mbledhur dhe analizuar të dhënat për përparimin e



studentëve dhe nuk ka mekanizëm për të identifikuar studentët me vështirësi në të nxënë dhe t'i mbështesë ata në studimet e tyre. Nuk ka ndonjë mekanizëm për të monitoruar performancën e shërbimeve studentore ose ndonjë plan për zhvillimin e tyre.

*Kapitulli i njëmbëdhjetë (Bashkëpunimi institucional / Nuk përmbushet):* Sipas ekspertëve, kolegji Dukagjini nuk ka paraqitur ndonjë strategji ndërkombëtarizimi që do të udhëzonte vendimet institucionale dhe alokimin e burimeve në këtë fushë, nuk ka informacione për marrëveshjet dhe memorandumet e mirëkuptimit me ndonjë partner apo organizatë përkatëse ndërkombëtare, por në vend të këtyre ka ofruar informacionet përkatëse të kolegjit UBT. Në raportin e vetëvlerësimit ekziston një listë e projekteve ndërkombëtare në të cilat UBT është përfshirë që nga themelimi i saj. Nuk ka as ndonjë informacion për organizimin e ngjarjeve me karakter ndërkombëtar, konferenca ndërkombëtare dhe shkolla verore. Stafii akademik i kolegjit Dukagjini përfshihet në ngjarjet ndërkombëtare të organizuara nga UBT. Ekspertët nuk gjetën informacione as për mobilitet të studentëve e profesorë nga jashtë vendit. E njëjta vlen edhe për bashkëpunimin me industrinë vendore dhe punëdhënësit, Sa i përket të diplomuarve, kolegji Dukagjini mban kontaktet me ata vetëm përmes mediave sociale, dhe kontakteve individuale mes profesorëve dhe të diplomuarve, por nuk ka ndonjë organizim formal të ashtuquajtur Alumni.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Dukagjini
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.